



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 499 Akti

Nr. 576 Vendimi
Tiranë, më 20.10.2022

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ester Arapi, në datë 18.10.2022 në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Enerjeta Shehaj**, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Enerjeta Shehaj është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, znj. Enerjeta Shehaj, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit, raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisioneren Firdes Shuli dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Enerjeta Shehaj, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 29.9.2022, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

I. SEANCA DËGJIMORE

7. Në datën 18.10.2022, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

7.1 Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, Znj. Enerjeta Shehaj, në lidhje me qëndrimin përfundimtar për procesin e rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

7.2 Seanca u ndërpre për të vijuar në datën 20.10.2022, ora 9:30, për shpalljen e vendimit të trupit gjykues.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

8. Subjekti i rivlerësimit Enerjeta Shehaj ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. VLERËSIMI I PASURISË

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/1. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

10. Referuar vendimit nr. 2/20173, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

11. Apartament me sipërfaqe 84 m²+10 m², në rrugën “****”, ***

11.1. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar pasurinë apartament me sipërfaqe 84 m²+10 m², në rrugën “****”, me kontratë premtim shitje nr. ***, datë 14.1.2014, lidhur midis shtetasit E.SH dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Vlera e këtij apartamenti është 62.000 euro.

11.2 Në këtë deklaratë personi i lidhur, në lidhje me pagesën e çmimit e blerjes, ka sqaruar, ndër të tjera, se vlera prej 45.600 euro është likuiduar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 7.5.2009, vlera prej 13.500 euro është likuiduar në kohën e lidhjes së kontratës së datës 14.1.2014 dhe shuma prej 2.900 euro është ende e palikuiduar.

11.3. Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj shume, personi i lidhur, ndër të tjera, ka sqaruar se: “...më parë në kohë mes meje dhe shoqërisë ‘****’ sh.p.k. (sot ‘****’ sh.p.k.) është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.5.2009, sipas së cilës unë merrja në përdorim një apartament me sipërfaqe 75m² në të njëjtin pallat me apartamentin që zotëroj sot. Vlera e këtij apartamenti ishte 48.000 euro. Kjo vlerë u likuidua nga ana ime në masën 45.600 euro, vlerë e konvertuar në lekë, sipas kursit të kohës u mbulua nga vlera në lekë e kredisë bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 për një kohëzgjatje 20 vjet, sipas kontratës nr. ***, datë 2.10.2009, pranë Bankës ***, si dhe nga hua e marrë në vlerën 2.500.000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.9.2009, nga shtetasi N.SH. Kam likuiduar edhe shumën 13.500 euro (diferencë e shtuar në vitin 2014) paguar nga huaja e marrë në vlerën 14.000 euro nga shtetasi N.SH, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013. Ndërkohë, që shuma 2.900 euro është një shumë ende e palikuiduar edhe sot...”

11.4. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar, kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 lekësh, sipas kontratës nr. ***, datë 2.10.2009, pranë Bankës **. Shuma e mbetur pa shlyer është 3.328.518 lekë, ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti, përveç detyrimit, në lidhje me kredinë e marrë të sipërcituar në formularin përkatës të detyrimeve, ka deklaruar edhe: (i) hua të marrë në vlerën 2.500.000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.9.2009, nga shtetasi N.SH (shuma e detyrimit të pashlyer 1.100.000 lekë); (ii) hua e marrë në vlerën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013, nga shtetasi N.SH (shuma e detyrimit të pashlyer 14.000 euro); (iii) këst i pashlyer nga çmimi total i pasurisë së paluajtshme sipas kontratës nr. ***, datë 14.1.2014, (shuma e detyrimit të pashlyer 2.900 euro).

11.5. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të pasurive, ndërsa bashkëshorti i subjektit, ndër të tjera, ka deklaruar se : *“...me kontratën e datës 14.1.2014 është revokuar kontrata e sipërmarrjes e datës 7.5.2009 e lidhur mes E.SH dhe shoqërisë ‘***’ sh.p.k. Me këtë kontratë është bërë premtim i shitblerjes të një apartamenti 84 m²-10 m² sipërfaqe e përbashkët dhe është anuluar gjithshka e përcaktuar në kontratën e mëparshme...”* dhe në rubrikën vlera në shifra dhe fjalë ka deklaruar *...13.500 euro është shtuar...”*.

11.6. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar kredinë bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale prej 4.000.000 lekësh me kohëzgjatje 20 vjet, sipas kontratës me nr. ***, datë 2.10.2009 (shlyer 12 këste me nga 38.000 lekë), ndërsa personi i lidhur bashkëshorti në këtë deklaratë (në seksionin e tij përkatës të detyrimeve) ka deklaruar edhe: (i) hua të marrë në shumën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013, e pashlyer. Kjo hua është deklaruar edhe në deklaratën vjetore të vitit 2013; (ii) hua marrë në vlerën 2.500.000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.9.2009 (shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 400.000 lekë dhe detyrim i mbetur 1.500.000 lekë); (iii) këst i pashlyer nga çmimi në total i pasurisë së paluajtshme, sipas kontratës nr. ***, datë 14.1.2015 (gjendje detyrimi 2.900 euro).

11.7. Me kontratën premtim shitblerje, datë 14.1.2014, palët, premtues shitës shoqëria “***” sh.p.k. përfaqësuar nga Y.Z dhe blerës z. E.SH, kanë rënë dakord për shitblerjen e apartamentit të banimit në katin e gjashtë teknik me sipërfaqe ndërtimore 84 m² dhe 10 m² sipërfaqe të përbashkët, ndodhur në rrugën “***”, ***, i cili nuk ka dokumentacion pronësie.

11.8. Në këtë kontratë është parashikuar që çmimi për shitblerjen është 62.000 euro, i cili është likuiduar dhe do të likuidohet, si vijon: (i) *kësti i parë prej 45.600 euro është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 7.5.2009; (ii) kësti i dytë prej 13.500 euro është likuiduar në prezencë të noteres, ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate; (iii) kësti i fundit prej 2.900 euro do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes.*

11.9. Me këtë kontratë është revokuar edhe kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.5.2009, e lidhur në mes shoqërisë “***” sh.p.k. dhe z. E.SH.

11.10. Në bazë të kontratës të datës 7.0.2009, shoqëria “***” sh.p.k. dhe porositësi E.SH kanë rënë dakord marrjen përsipër dhe ndërtimin e apartamentit nr.1, në katin e 4 teknik me sip. 75 m² bashkë me ambientet e përbashkëta, kundrejt çmimit prej 48.000 euro.

11.11. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk deklaroi ndryshime në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndërsa personi i lidhur ka deklaruar, ndër të tjera, se *pasuri e paluajtshme shtëpi banimi porositur në datën 7.5.2009, e paregjistruar në regjistrin publik, sip. 75 m² në adresë rruga “***”, sipas kontratës së sipërmarrjes së datë 7.5.2009, në shumën 48.000 euro.*

11.12. Si detyrime financiare subjekti ka deklaruar *kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale 4.000.000 lekë, sipas kontratës, datë 2.10.2009, e lidhur në Bankën ****, ndërsa personi i lidhur ka deklaruar *hua e marrë nga babai N.SH, sipas deklaratës noteriale, datë 16.9.2009, në shumën 2.500.000 lekë (pa shlyer asgjë deri në datë 31.12.2009 dhe pjesë e mbetur e pashlyer nga vlera e apartamentit të porositur në shumën 2.400 euro.*

11.13. Në DPV-në e vitit 2012 para fillimit të detyrës, personi i lidhur ka deklaruar: “Pasuri e paluajtshme, shtëpi banimi e porositur në datën 7.5.2009, e paregjistruar në regjistrat publikë me sip. 78 m², në vlerë totale 48.000 euro me adresë në rruga “****” ose rruga “****” pall. i ri, pranë spitalit ***, me kontratën nr. ***, datë 7.5.2009. Gjithashtu, ka deklaruar: (i) kredi bankare afatgjatë për blerje shtëpie në shumën totale 4.000.000 lekë, sipas kontratës nr. ***, datë 2.10.2009; (ii) hua e marrë në vlerën 2.500.000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.9.2009; (iii) vlera 2.400 euro e pashlyer.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

11.14. Në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 7.5.2009, e lidhur në mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. E.SH, është përcaktuar se pagesa e çmimit prej 48.000 euro, do të kryhej: kësti i parë deri në datën 11.5.2009, në shumën 30.000 euro; kësti i dytë në shumën 18.000 euro, deri në momentin e dorëzimit të apartamentit, ndërsa pagesa për pjesën e mbetur do të kryhet pranë *** në nr. e llogarisë të shoqërisë ose me mandatpagesë të lëshuar nga z. Y.Z.

11.15. Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në DPV-në e vitit 2009, burimin e të ardhurave për blerjen /krijimin e kësaj pasurie, por në detyrime është shprehur se kredia në Bankën *** ka pasur si objekt “blerje shtëpie”, ndërsa për sa i përket shumës së deklaruar si hua nga babai i tij, nuk është deklaruar qëllimi i marrjes, por është referuar deklarata noteriale e datës 16.9.2009.

11.16. Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 7.10.2009, shoqëria ndërtimore dhe shtetasi E.SH deklarojnë se kanë shlyer shumën prej 15.600 euro nga kësti i dytë i çmimit të përcaktuar në kontratën e datës 7.5.2009 dhe pjesa e ngelur papaguar nga kësti i dytë është 2.400 euro, e cila do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes.

11.17. Në procesverbalin e mbajtur në datën 10.11.2014, pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, të pyetur në lidhje me kohën e likuidimit të pagesës së shumës 48.000 euro, kanë deklaruar, ndër të tjera, se: “...pagesa është kryer sipas kushteve të kontratës dhe, konkretisht, vlera 30.000 euro në datën 11.05.2009 dhe vlera 15.600 euro në datën 7.10.2009. Ky apartament është bërë i banueshëm nga ana jonë në tetor të vitit 2009...”.

11.18. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: “...ky apartament ka kaluar në përdorimin tonë pas pagesës së këstit të dytë të likuidimit të tij në tetor të vitit 2009 dhe kemi qëndruar aty deri në shkurt të vitit 2014...”.

i) Analiza e burimit të deklaruar të të ardhurave për pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit në datën 11.5.2009, në shumën 30.000 euro dhe mundësia financiare

11.19. Komisioni ka analizuar burimet e krijimit, referuar deklaramit të subjektit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, ka krahasuar atë me deklaratën vjetore të subjektit dhe personit të lidhur me të, si dhe ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në kuptim të vërtetësisë së deklarimeve, si dhe provueshmërisë së burimeve të krijimit.

11.20. Në lidhje me kredinë bankare në shumën 4.000.000 lekë, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe administruar në kuadër të rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se kredia është marrë në datën 6.10.2009, pranë “***” nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, kredi e cila rezulton e mbyllur në datën 6.12.2017.

11.21. Në vijim ka rezultuar se subjekti ka tërhequr këtë kredi në pjesë: në datën 6.10.2009 ka tërhequr shumën *cash* 2.200.000 lekë; në datën 8.10.2009 ka tërhequr shumën *cash* 400.000 lekë; në datën 13.11.2009 ka tërhequr shumën *cash* 100.000 lekë; si dhe në datën 31.12.2009 ka tërhequr shumën 1.247.000 lekë.

11.22. Duke qenë se kredia është disbursuar para pagesës së këstit të parë prej 30,000 eurosh, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime gjatë hetimit administrativ, si dhe ka administruar dhe vlerësuar dokumentacion provues të paraqitur nga subjekti, në lidhje me burimet e krijimit.

11.23. Për të vlerësuar në lidhje me burimet financiare për krijimin e shumës prej 2.500.000 lekë dhënë hua nga babai i subjektit, z. N.SH, në vitin 2009, Komisioni ka analizuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si dhe përgjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, si dhe dokumentacionin e siguruar nga hetimi administrativ.

11.24. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur dokumentacion vijues për të provuar mundësitë financiare të z. N.SH: (i) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e z. N.SH për periudhën 1998 – 2010; (ii) vërtetim nga ISSH-ja për pagat e nënës K.SH për periudhën korrik 2004 – mars 2006 e në vijim nga janar 2012 – gusht 2020; (iii) kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme të vitit 2001, të lidhur midis shtetasve N. dhe K.SH në cilësinë e shitësve dhe shtetasit P.Z në cilësinë e blerësit, për shitjen e një sipërfaqe trualli prej 560 m², në qytetin e ***, me dokumentacion: (iv) deklaratë noteriale me nr. ***, datë 12.9.2009, lëshuar nga shtetasit S.N dhe N.SH, sipas të cilës kanë deklaruar se për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, z. S.N i jep djalit të dajës z. N.SH një shumë hua prej 1.500.000 lekësh pa interes dhe për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj, të cilën z. SH *do ta përdorë bashkë me kursimet e tij të mbledhura ndër vite, për t'ia dhënë subjektit të rivlerësimit me qëllim likuidimin e një apartamenti të porositur prej tij në ****; (v) vërtetim me nr. *** prot., datë 20.1.2021, nga DRT-ja Gjirokastër, në lidhje me qarkullimin vjetor të realizuar nga personi fizik “***” me NIPT ***, me objekt aktiviteti “tregti më pakicë artikujsh ushqimorë etj.”, për vitet 2004, 2005 dhe 2006, bashkë me dokumentacionin mbështetës; (vi) vërtetim nr. *** prot., datë 29.12.2020, lëshuar nga Bashkia Gjirokastër në lidhje me pagesën e detyrimeve të taksave

vendore për periudhën nga viti 2002 – 2009, nga personi fizik “****”; (vii) shkresë me nr. *** prot., datë 31.12.2020, kthim përgjigjeje, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Gjirokastër, drejtuar z. S.N, bashkë me dokumentacionin mbështetës.

11.25. Nga vlerësimi i dokumentacionit konstatohet se të ardhurat e prindërve të subjektit, për periudhën 1 janar 1998 - 16 shtator 2009, rezultojnë të jenë në vlerën totale rreth 4.317.000 lekësh dhe pas zbritjes së shpenzimeve jetike, për periudhën 1 janar 1998 – 16 shtator 2009, në vlerën rreth 2.602.000 lekë, mundësia e prindërve për të kursyer do të ishte maksimalisht rreth 1.714.000 lekë. Gjithashtu, nga vlerësimi në tërësi i dokumentacionit në lidhje me mundësitë financiare të z. S.N për t’i dhënë hua babait të subjektit shumën 1.500.000 lekë, duket se ai ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si person fizik me objekt “tregti e artikujve të ndryshëm” dhe nga shitja e dy pasurive të paluajtshme ndër vite si individ. Në analizën e kryer fillimisht nga Komisioni, këto burime nuk u konsideruan, për shkak të mosdeklarimit të tyre në deklaratën *Vetting*, si burime të pagesës së kështit të parë të apartamentit.

11.26. Nga analiza e kryer, mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga hetimi, Komisioni përgatiti analizën financiare paraprake, për sa nuk u provua shlyerja e kështit të parë prej 30.000 euro me burim nga kredia pranë Bankës *** dhe nga huaja e marrë nga babai i bashkëshortit të subjektit.

11.27. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës që të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, për sa duket se: (i) Huat që babai i bashkëshortit të subjektit i ka marrë shtetasit S.N dhe shoqërisë “****” sh.p.k., nuk mund të përfshihen si burim për huat që shtetasi N.SH (vjeherri i subjektit), i ka dhënë personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), z. E.SH, pasi: nuk janë deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj; nga ana logjike duket e paqartë se si vjeherri i subjektit mori hua nga z. S.N dhe shoqëria “****”sh.p.k., për t’ia dhënë hua djalit të tij (bashkëshortit të subjektit), me qëllim blerje apartamenti, kur këto hua mund të merreshin drejtpërdrejt nga ky i fundit; nuk evidentohen gjurmë financiare të marrjes, destinacionin e këtyre shumave pas marrjes, si dhe koha dhe mënyra e shlyerjes së këtyre huave nga z. N.SH; si dhe nga të dhënat të RNSH-së, nuk rezulton të jetë regjistruar akti noterial me nr. ***, datë 15.11.2013, redaktuar nga noter A.A.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.28. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Dhënia e huas prej 30.000 euro nga subjekti ‘****’ sh.p.k. dhe kthimi i saj brenda vitit 2009, ka qenë një modalitet apo veprim i nxitur nga një nevojë imediate, si një kërkesë e ndërtuesit për paguar në favor të tij, shumën prej 30.000 euro, pasi në të kundërt apartamentin do t’ia jepte një porositësi tjetër. Nga sa më sipër, sikurse edhe Komisioni ka konstatuar, qoftë borxhi i dhënë dhe kthyer brenda vitit 2009 nga subjekti ‘****’ sh.p.k., karshi babait të bashkëshortit N.SH, ashtu edhe huaja e dhënë nga z. S.N, si pjesë për të plotësuar shumën prej 2.500.000 lekë, janë dokumentuar me akte noteriale publike, në kohën kur këto veprime janë kryer si edhe kanë pasqyruar në*

përmbajtje të tyre, të gjithë elementët që lidhen me: palët, shumën, afatin dhe qëllimin për të cilin këto hua janë dhënë.

*Marrëdhëniet e huamarrëse ndërmjet vjehrrit tim N.SH, referuar këtu : (i) borxhit të marrë dhe kthyer brenda vitit 2009 me subjektin ‘***’ sh.p.k.; dhe (ii) huas së marrë nga z. S.N për të plotësuar shumën prej 2.500.000 lekë, të dyja veprime të kryera në vitin 2009, pikë së pari, lidhen me marrëdhënie të posaçme farefisnore. Bashkëshorti ka qenë në moshën rreth 26-27 vjeç, edhe vjehrrri z. N.SH, jo vetëm si garantues, por edhe si mbështetje për djalin e tij relativisht të ri, ka menduar që borxhli të dalë ai vetë dhe jo ne. Ky fakt nuk përbën asnjë rezervë për sa i përket detyrimit që bashkëshorti dhe unë, si subjekte të ligjit nr. 84/2016, mbartim për të justifikuar burimin e ligjshëm të shumave që na janë huazuar në periudhën e rivlerësimit, në kuptim kjo edhe të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.*

*Në lidhje me gjurmët financiare të marrjes, destinacionit dhe kohës e shlyerjes së huave nga z. N.Sh, për sa i përket borxhit prej 30.000 euro të marrë nga shoqëria ‘***’ sh.p.k., periudha e marrjes së saj është e qartë për sa i referohemi deklaratës noteriale nr. ***, datë 30.4.2009, e cila citon se ‘me cilësinë e Administratorit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. deklaroj se sot i jap shtetasit N.SH në formë huaje, shumën prej 30.000 euro pa interes, për një periudhë kthimi deri në fund të vitit 2009’. Huamarrësi N.SH deklarohen se ‘shumën e huas prej 30.000 euro e kam marrë me qëllim për t’ia dhënë djalit për prenotimin e një apartamenti në *** dhe se këtë shumë do ta shlyej huadhënësit deri në fund të vitit 2009...’.*

*Për sa i përket faktit të kthimit të kësaj huaje, përveç sa është cituar zotimit të palëve për ta kthyer deri në fund të vitit 2009, huadhënësi Subjekti ‘***’ sh.p.k., ka lëshuar edhe deklaratën nr. ***kol., nr. *** rep., datë 2.1.2022, përmes të cilës deklararon se ‘sipas përshkrimit të deklaratës noteriale nr. ***, datë 30.4.2009, më është kthyer brenda vitit 2009 dhe pas këtij viti nuk ka pasur asnjë detyrim të prapambetur as nga N.SH dhe as nga djali i tij’.*

Në lidhje me huan në shumën 1.500.000 lekë, të vitit 2009

*11.29. Në lidhje me huan e marrë në vitin 2009, e cila ka shërbyer për të plotësuar shumën prej 2.500.000 lekë, periudhës së dhënies, destinimit dhe qëllimit të saj, i jepet përgjigje e mjaftueshme në deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.9.2009, huadhënësi deklararon se ‘për shkak të lidhjeve të ngushta familjare i jap djalit të dajës N.SH një shumë prej 1.500.000 lekë, pa interes dhe për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj’. Huamarrësi z. N.SH ka deklaruar se ‘ka marrë nga djali i hallës së tij S.N, shumën prej 1.500.000 lekë pa interes, për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj.*

*Akti noterial nr. ***, datë 16.9.2009, është përpiluar rregullisht para noterit, duke u deklaruar rregullisht në DVP/2009 e personit të lidhur si ‘Hua e marrë nga babai im N.SH sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.9.2009, në shumën 2.500.000 lekë’. Në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se ‘Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit’.*

*Nga ana tjetër huaja prej 14.000 euro, e dokumentuar përmes deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013, rezulton e deklaruar në DPV/2013 të personit të lidhur. Mosgjetja e ekstremiteve të akteve noteriale të përpiluara nga noteri A.A, në sistemin RNSH-së, nuk krijon asnjë dyshim në lidhje me ekzistencën apo vlefshmërinë e tyre.*

*Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës ndër të tjera ka deklaruar se: “për krijimin e shumës së huazuar në masën prej 2.500.000 lekë kanë shërbyer: (i) kursimet nga pagat e prindërve të bashkëshortit; (ii) shitja e një pasurie të paluajtshme prej tyre; dhe (iii) dhe një hua e dhënë nga i afërmi i babait të bashkëshortit. Në lidhje me dokumentimin dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, aktet që konfirmojnë punësimin dhe të ardhurat e siguruar nga prindërit janë: dokumentacioni mbi tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme në qytetin e ***, si edhe deklarata noteriale e kohës së bashku me dokumentacionin ligjor-financiar të personit që ka huazuar pjesërisht në krijimin e totalit prej 2.500.000 lekë.*

Në lidhje me të ardhurat nga punësimi i prindërve të bashkëshortit dhe ato të siguruara nga shitblerja e pasurisë së paluajtshme, vlerësoj hetimet e kryera nga Komisioni. Në raport me huan e dhënë nga i afërmi i babait të bashkëshortit z. S.N, ju lutem që pasi të administroni dokumentacionin e nevojshëm, kërkoj që edhe kjo e ardhur të përlllogaritet në mundësinë e dhënies së huas, pasi në përputhje me nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, huaja konkrete plotëson të gjitha kriteret e ligjshmërisë, pasi është e deklaruar, e dokumentuar dhe regjistruar me akt noterial publik dhe mbi të gjitha, për këto të ardhura janë likuiduar detyrimet tatimore”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.30. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit dhe në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, dhe paraqiti shpjegime bindëse për sa i përket pagesës së kështit të parë në vlerën 30.000 euro, brenda datës 15.5.2009.

11.31. Në lidhje me huan prej 30.000 euro dhënë nga shoqëria “****” sh.p.k., babait të bashkëshortit të subjektit, Komisioni konstaton se në deklaratën noteriale të datës 30.4.2009 paraqitur si provë nga subjekti, citohet se: “...shoqëria ‘***’ sh.p.k. i ka dhënë sot z. N.SH një shumë prej 30.000 euro në formën e një huaje pa interes për një periudhë kthimi deri në fund të vitit 2009, me qëllim për t’ia dhënë djalit të tij për prenotimin e një apartamenti në qytetin ***...”.

11.32. Nga hetimi rezultoi se brenda datës 15.5.2009 administratori i shoqërisë së ndërtimit ka depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë pranë ***-së, shumën 30,000 euro me përshkrimin “dep. për blerje apartamenti nr. 1, kati 4, teknik E.SH”.

11.33. Huaja e dhënë nga shoqëria e mësipërme vërtetohet me deklaratën noteriale të kohës, e cila i jep vlerë provuese pretendimit të subjektit në lidhje me burimin e pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit. Subjekti, gjithashtu, arriti të provonte me dokumentacion ligjor provues burimin e krijimit të shumës së dhënë nga shoqëria me xhiron e aktivitetit tregtar, për periudhën e përcaktuar 1 janar -30 prill të vitit 2009.

11.34. Referuar dokumentacionit në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., rezulton se subjekti tregtar është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datën 16.10.1997, me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit dhe import-eksporteve. Kapitali i saj është në vlerën 80.069.567 lekë, i cili zotërohet nga dy ortakë, z. S.Ç me 66% të pjesës takuese në këtë kapital dhe z. J.M me 34% të kapitalit.

11.35. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor, në lidhje me volumin e aktivitetit tregtar të deklaruar në organin kompetent tatimor, evidentohet se shoqëria “****” sh.p.k., ka realizuar një xhiro prej 9.587.320 lekësh në periudhën janar - prill 2009 dhe xhiro vjetore prej 127.386.052 lekësh. Fitimi i tatueshëm vjetor i rezultuar për këtë shoqëri në vitin 2009 ka qenë në vlerën 13.237.163 lekë. Gjithashtu, nga verifikimi i ekstraktit të llogarisë së shoqërisë “****” sh.p.k., në “**** Bank”, për periudhën kohore 8.1.2009-24.4.2009 rezulton se janë kryer veprime tërheqje *cash* nga llogaria e shoqërisë, në shumën totale 12.500.000 lekë, likuiditete të cilat justifikojnë mjaftueshëm shumën e dhënë hua prej 30.000 euro.

11.36. Nga analiza e shpjegimeve të subjektit, në raport me faktet dhe dokumentacionin provues në lidhje me to, krijohet bindja se shuma prej 30.000 eurosh është shlyer me huan e dhënë nga babai i bashkëshortit të subjektit në vlerën 2.500.000 lekë, sipas deklaratës noteriale të datës 16.9.2009 dhe me kredinë e marrë pranë Bankës *** në datën 2.10.2009, pra, pjesën e mbetur të kredisë në shumën 1.750.000 lekë, kredi e cila u tërhoq deri në datën 31.12.2009.

11.37. Në lidhje me burimet që i kanë shërbyer babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës 2.500.000 lekë dhënë hua në datën 16.9.2009, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni për të justifikuar burimet e ligjshme të krijimit, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i gjeti ato bindëse.

11.38. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor të paraqitur nga subjekti provohet se në datën 12.9.2009 babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i ka marrë hua kushëririt të tij, z. S.N, një shumë prej 1.500.000 lekësh, pa interes, për një periudhë të pacaktuar për kthimin e saj, sipas një deklaratë noteriale të nënshkruar nga z. S.N dhe z. N.SH, në kohën e marrjes së saj. Sipas kësaj deklaratë citohet se babai i bashkëshortit të subjektit do ta përdorë huan e marrë bashkë me kursimet e tij të mbledhura, ndër vite, për t’ia dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me qëllim likuidimin e një apartamenti të porositur prej tij në Tiranë.

11.39. Më tej, Komisioni ka verifikuar edhe regjistrimin e kësaj deklaratë noteriale në regjistrat noterialë publikë, sipas të cilit noteri publik ka informuar në lidhje me regjistrimin e deklaratës në regjistrin noterial të kohës, duke dërguar kopje të njësuar të regjistrit të akteve dhe veprimeve noteriale, ku evidentohet e regjistruar edhe deklarata noteriale e datës 12.9.2009.

11.40. Komisioni, lidhur me mosregjistrimin e veprimit noterial të vitit 2013 bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, dhe mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë të kundërtën e barrës së provës, lidhur me këtë fakt të konstatuar.

11.41. Si përfundim, nga analizimi i veprimeve të kryera në lidhje me marrjen e huas të babait të subjektit nga z. S.N, për t'ia dhënë në vijim subjektit të rivlerësimit për krijimin e shumës prej 2.500.000 lekësh, krijohet bindja se ato janë të ndërlidhura në kohë me njëra-tjetrën. Gjithashtu, provohet me deklaratë të kohës se huaja e dhënë subjektit të rivlerësimit në shumën prej 2.500.000 lekësh ka pasur burim krijimi të ardhurat e marra hua nga z. S.N në shumën prej 1.500.000 lekësh, si dhe kursimet e z. N.SH.

11.42. Trupi gjykues analizoi mbi mundësitë financiare të z. S.N për të dhënë hua babait të subjektit shumën si më sipër. Në analizën e kryer u konsiderua dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të huas, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

11.43. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur në lidhje me z. S.N, duket se ai ka realizuar qarkullim vjetor të konsiderueshëm deri në vitin 2008. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme, ka realizuar të ardhura si individ, në vlerën 2.500.000 lekë, për të cilat janë paguar detyrimet përkatëse tatimore dhe duket se këto të ardhura kanë qenë të mjaftueshme për t'i dhënë z. N.SH huan në shumën 1.500.000 lekë.

11.44. Më tej, nga analizimi i të ardhurave nga pagat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, për periudhën 1 janar 1998 – 16 shtator 2009, në shumën 4.317.000 lekë, pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë, në vlerën rreth 2.602.000¹ lekë, mundësia e tyre për të kursyer rezultoi rreth 1.714.000 lekë, të ardhura të cilat janë mjaftueshme për të mbuluar vlerën prej 1.000.000 lekësh, si burim krijimi i huas së dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij në shumën 2.500.000 lekë.

11.45. Bazuar në faktet, provat e analizuara më lart, si dhe legjislacionin në fuqi, trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke provuar pagesën e kështit të parë prej 30.000 euro brenda datës 15.5.2009, me burime të dokumentuara dhe të ligjshme.

ii) Analiza e burimit të deklaruar të të ardhurave për pagesën e kështit të dytë të çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 75 m², në ***

11.46. Në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 7.10.2009, shoqëria ndërtimore dhe shtetasi E.SH deklarojnë se kanë shlyer shumën prej 15.600 euro nga kësti i dytë i çmimit të përcaktuar në kontratën e datës 7.5.2009 dhe pjesa e ngelur papaguar nga kësti i dytë është 2.400 euro, e cila do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes.

11.47. Në dosjen *Vetting* subjekti ka depozituar kontratë kredie bankare, datë 2.10.2009, ndërmjet Bankës *** dhe kredimarrësve E. dhe Enerjeta Shehaj, për marrjen e kredisë në shumën 4.000.000 lekë për blerje shtëpie, me një kohëzgjatje 20 vjet. Si garanci për shlyerjen e kredisë është vënë apartamenti me sip. 73.5 m², në rrugën “***”, ***, në pronësi të z. A.D (babai i subjektit).

¹Shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas ILDKPKI-së për 2 persona; përkatësisht për periudhën 2000 – 2009, sipas ILDKPKI-së, ndërsa për vitet 1998 –1999, sipas shpenzimeve të vitit 2000, sipas informacionit të ILDKPKI-së, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

11.48. Referuar të dhënave nga *** Bank rezulton se në datën 6.10.2009 është disbursuar kredia në shumën 4.000.000 lekë. Në datën 6.10.2009 është tërhequr *cash* shuma prej 2.200.000 lekësh, në datën 8.10.2009 është tërhequr *cash* shuma 400.000 lekë, në datën 4.12.2009 është tërhequr *cash* shuma 100.000 lekë dhe në datën 31.12.2009 është tërhequr *cash* shuma 1.247.000 lekë. Kjo kredi është shlyer plotësisht në datën 22.11.2017 me një transfertë në shumën 3.442.000 lekë, me burim një kredi të re të marrë në “*** Bank”, në vlerën 3.300.000 lekë të disbursuar në datën 31.7.2017.

11.49. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin sa më sipër, ka vlerësuar se shuma e tërhequr *cash* nga llogaria bankare në *** Bank, në datën 6.10.2009, në vlerën 2.200.000 lekë, me burim kredinë e disbursuar në të njëjtë ditë, duket se ka qenë e mjaftueshme për likuidimin e shumës prej 15.600 euro, datë 7.10.2009, gjithsesi, Komisioni në vlerësim të faktit se në këtë vit subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar kursime *cash* në banesë shumën 630.000 lekë (300.000 lekë +2.400 euro), kreu një analizë financiare për periudhën 12.5.2009 – 31.12.2009, nga e cila rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për pagesën e kështit të dytë të çmimit të blerjes së apartamentit, krijim pasurish, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 12.5.2009-31.12.2009.

iii) Analiza e burimit të deklaruar të të ardhurave për pagesën e kështit shtesë në shumën 13.500 euro në datën 14.1.2014, të çmimit të blerjes së sipërfaqes shtesë të apartamentit në ***

11.50. Në kontratën premtim shitblerje, datë 14.1.2014, është parashikuar, ndër të tjera, se kësti i dytë prej 13.500 euro është likuiduar në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

11.51. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit, në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e shumës prej 13.500 euro, ka deklaruar se: “... është paguar nga huaja e marrë në vlerën 14.000 euro nga shtetasi N.SH, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013...”.

11.52. Në DPV-në e vitit 2014, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar: “... hua e marrë në vlerën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013...”.

11.53. Me deklaram noterial nr. ***, datë 15.11.2013, z. N.SH ka deklaruar se i ka dhënë hua z. E.SH, një shumë prej 14.000 euro, për blerjen e shtëpisë në qytetin e ***.

11.54. Në DPV-në e vitit 2013, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, bashkëshorti i subjektit, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizike”, ndër të tjera, ka deklaruar: “... hua e marrë në vlerën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013...”.

11.55. Në pyetësorin nr. 2, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...pasi është shfaqur mundësia e një apartamenti me sipërfaqe më të madhe.....bashkëshorti ka rënë dakord për vlerën e apartamentit me sip. 84 m². Për këtë arsye, bashkëshorti ka marrë hua nga babai i tij shumën prej 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013. Kjo hua është deklaruar në DPV/2013 nga bashkëshorti. Destinacioni i kësaj huaje ishte likuidimi i kështit të apartamentit të kontraktuar përmes kontratës për premtim shitje pasurie. Në lidhje me huan në vlerën 14.000 euro

të dhënë nga babai i bashkëshortit në fund të vitit 2013, e cila ka shërbyer për pagimin e këstit prej 13.500 euro në janar të vitit 2014, në funksion të kontratës premtim shitje, datë 14.1.2014, i bëj me dije Komisionit se shuma prej 14.000 euro ka si burim të saj, kursime nga paga të babait dhe nënës së bashkëshortit ndër vite”.

11.56. Në procesverbalin e datës 10.11.2014 të mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti dhe bashkëshorti, ndër të tjera, kanë deklaruar: (i) në përgjigje të pyetjes nr. 6, se qëllimi i marrjes së kësaj huaje është për faktin se sipas kontratës së premtim shitblerjes të datës 14.1.2014, është ndërruar kati i banimit në pallatin dhe adresën e njëjtë të deklaruar në vitin 2009, pra, është shtuar sipërfaqja e banimit me rreth 19 m² kundrejt vlerës shtesë prej 13.500 euro. Pra, huamarrja në vlerën 14.000 euro është marrë për shtesë sipërfaqe banimi. Referuar kësaj kontrate shlyerja e shumës prej 13.500 euro është bërë në datën 14.1.2014, e cila i përket deklarimit periodik vjetor të vitit 2014, ndërsa në lidhje me mundësitë ekonomike të huadhënësit kanë deklaruar se janë ato të përshkruara më sipër (pra, të ardhurat nga emigracioni dhe shitja e truallit me sip. 560 m², në qytetin e *** në vitin 2001).

11.57. Referuar nenit 4, pika “d”, e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, sipas të cilit subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendjen në *cash* jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, Komisioni vlerëson se subjekti, duhet të deklaronte saktë edhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* apo në bankë në fund të vitit 2013.

11.58. Sa më sipër, duket se nga subjekti dhe /ose personi i lidhur (bashkëshorti i saj) nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2013, shuma 14.000 euro (e marrë hua në datën 15.11.2013), si gjendje *cash* shtesë në banesë në datën 31.12.2013 (konfirmuar edhe me përgjigjen e dhënë në ILDKPKI në datën 10.11.2014).

11.59. Në shpjegimet dhe provat të rezultateve të hetimit administrativ, të përcjella nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 7.1.2022, z. E.SH, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...në lidhje me faktin e prezantimit të kësaj huaje në DPV/2013, bëj me dije se këtë vlerë huaje e kam dokumentuar përmes deklaratës noteriale të datës 15.11.2013, kur e kam marrë prej babait tim. Si të tillë pavarësisht ditës se kur do të bëja pagimin e saj tek shitësi, nuk kam patur asnjë motiv që këtë vlerë monetare ta merrja e mbaja në shtëpi, ndërkohë që kam gjykuar se ka qenë më e sigurt që ajo të qëndronte në banesën e prindërve në qytetin e ***. Këtë hua e kam marrë dhe poseduar fizikisht në momentin kur e kam paguar në favor të ndërtuesit, në janar 2014...”.

11.60. Bashkëshorti i subjektit rezulton të ketë deklaruar në DPV-në e vitit 2013, ndër të tjera, edhe shumën prej 14.000 euro, si detyrim për t’u shlyer ndaj huadhënësit (me përshkrimin “hua e marrë në vlerën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 7.5.2009”).

11.61. Sa më sipër, Komisioni, në analizën e burimeve të të ardhurave të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur për pagesën e këstit të apartamentit në shumën 13.500 euro, ka vlerësuar të mos pasqyrohet huaja e marrë nga babai i bashkëshortit në datën 15.11.2013, në shumën 14.000 euro, por të përfshihet vetëm shuma prej 300.000 lekësh deklaruar gjendje *cash* në datën 31.12.2013.

11.62. Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, kreu një analizë paraprake të treguesve financiarë, për harkun kohor 1.1.2014-14.1.2014, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 94 m², në shumën 13.500 euro, në Tiranë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, nga e cila duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën në datën 14.1.2014, të shumës 13.500 euro, si këst i çmimit të blerjes së pasurisë apartament me sipërfaqe të përgjithshme 94 m², në ***, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2014-14.1.2014.

11.63. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit

11.64. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Për efekt të deklarimit si subjekte të ligjit nr. 9049/2003, pavarësisht nëse kjo kontratë do të nënshkruhej në fund të vitit 2013 apo fillim të vitit 2014 bashkëshorti me babain e tij kanë zgjedhur që këtë marrëdhënie detyrimi, ta dokumentojnë me deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.11.2013. Në objektin e kësaj deklarate është shpjeguar qëllimi i marrjes së saj. Pas lirimit të apartamentit me sip. 84 m², në janar të vitit 2014 bashkëshorti dhe ndërtuesi kanë nënshkruar kontratën e premtim shitjes me datë 14.1.2014, periudhë në të cilën është likuiduar edhe shuma prej 13.500 euro. Në lidhje me këtë deklarim, Komisioni nuk e përllogarit vlerën prej 14.000 euro të huazuar nga babai i bashkëshortit si destinim për pagesën e këstit të tretë prej 13.500 euro. Qëllimi dhe përdorimi i huas së marrë nga babai i bashkëshortit në shumën prej 14.000 euro, ka qenë i deklaruar në mënyrë të rregullt në DPV-në e vitit 2013, duke u përshkruar si ‘hua e marrë në vlerën 14.000 euro, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013’.*

*Po kështu, është deklaruar edhe në DPV-të për vitet 2014-2016, si dhe në deklaratën Vetting, pagesa e këstit të tretë është deklaruar me burim “është paguar nga huaja e marrë në vlerën 14.000 euro nga shtetasi N.SH, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.11.2013...”. Në pyetësorin e paraqitur nga Inspektorati në tetor/2014, qëllimi i marrjes së huas është deklaruar: “huamarrja në vlerën 14.000 euro është marrë për shtesë sipërfaqe banimi. Referuar kësaj kontrate shlyerja e shumës prej 13.500 euro është bërë në datë 14.01.2014...”.*

Për këtë arsye, subjekti i ka kërkuar Komisionit që vlerën e kësaj huaje ta përllogaritë si burim i pagesës së këstit të tretë të apartamentit në janar të vitit 2014. Rrethana e mosdeklarimit të huas si gjendje cash në fund të vitit 2013, ajo ka deklaruar se nuk e ka poseduar cash derisa e ka marrë dhe dhënë ndërtuesit në janar të vitit 2014, edhe deklarimi vijues i saj, ka dokumentuar të njëjtën rrethanë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.65. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit në lidhje me pagesën e këstit të tretë të çmimit të apartamentit, i vlerësoi ato bindëse. Nga analizimi i veprimeve juridike të kryera me qëllim shlyerjen e pagesës së këstit të tretë, vihet re se ato janë të lidhura ngushtësisht në kohë me njëra tjetrën. Pra, në datën 15.11.2013 është nënshkruar deklarata noteriale në lidhje me huan në shumën prej 14.000 eurosh, dhënë bashkëshortit të subjektit nga babai i tij dhe në datën 14.1.2014 është lidhur kontrata për premtim shitjeje në zbatim të së cilës është paguar shuma prej 13,500 eurosh para noterit publik.

11.66. Në lidhje me mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2013 të gjendjes së likuiditeteve prej 14,000 euro nga huaja, sipas deklaratës noteriale të datës 15.11.2013, trupi gjykues vlerëson se nga analizimi i shpjegimeve të subjektit në lidhje me mospasjen në posedim të kësaj shume, në raport me faktet e rezultuara në vijim nga analizimi i provave për pagesën e këstit të radhës në shumën 13,500 euro, këto shpjegime janë bindëse.

11.67. Nga të gjitha faktet e prezantuara, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej saj në aspektin logjik, *se nuk e ka zotëruar gjendjen cash derisa e ka marrë dhe dhënë ndërtuesit në janar të vitit 2014.*

11.68. Nga provat e administruara në hetim nuk rezultoi asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e kësaj rrethane dhe situatë të shpjeguar nga subjekti.

11.69. Në konkluzionin për sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, subjekti ishte bindëse në shpjegimet e saj duke arritur, për rrjedhojë, në konkluzionin se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pagesën e këstit prej 13,500 euro me burim nga huaja në shumën 14,000 euro dhënë nga babai i bashkëshortit të saj.

12. Automjet tip “**”, me targa ***, në pronësi të personit të lidhur/ bashkëshortit të subjektit**

12.1. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar, ndër të tjera, automjetin tip “****”, me targa ***, prodhim i vitit 2005, përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2016, kundrejt vlerës 300.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016, në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, ka deklaruar ndryshime të pasurive dhe burim të krijimit, konkretisht: *“...me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2016, kam blerë nga shtetasi A.K automjetin tip “****”, me targa ***, ngjyrë jeshile, prodhim i vitit 2005, në shumën 300.000 lekë ...”.*

12.2. DPSHTRR-ja ka informuar se shtetasi E. N.SH aktualisht ka të regjistruar mjetin me targa ***.

12.3. Në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2016, shtetasi E.SH ka blerë nga shtetasi A.K autoveturën e markës “****”, tip ***, me targa ***, në vlerën 300.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

12.4. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj autoveture, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit), si në deklaratën *Vetting* ashtu edhe në DPV-në e vitit 2016, ka deklaruar se *ky mjet është blerë me të ardhura të kursyera nga paga ime dhe e bashkëshortes*, por pa shpjeguar se burimi i deklaruar i referohet kursimit nga të ardhurat nga paga të vitit 2016 deri në datën e blerjes së pasurisë, apo kursimeve të akumuluar në banesë, nga të ardhurat nga pagat, të deklaruar si gjendje deri në datën 31.12.2015.

12.5. Në shpjegimet dhe provat në rezultatet e hetimit administrativ, të përcjella nga bashkëshorti i subjektit në datën 7.1.2022, z. E.SH, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...prej meje si subjekt deklarues, gjendja e likuiditeteve cash për çdo vit është konceptuar, si një vlerë e cila dëshmon shumën e likuiditeteve që kam pasur në banesë në datën 31/12 të çdo fundvit. Në të gjitha rastet, një shumë e deklaruar kursim, në mbyllje të vitit të kaluar (më 31/12), në vitin që pasonte është konsumuar apo shtuar sipas nevojave dhe mundësisë që krijoheshin në këtë vit pasues, përsëri deklarohet gjendja në cash, e cila përfshinte dhe ndryshimet nga viti i mëparshëm...”*.

12.6. Në DPV-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“...të ardhura të kursyera nga të ardhurat e përditshme, të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime për vitin 2016, shuma 350.000 lekë”*. Referuar këtij deklarimi, duket se shuma prej 350.000 lekësh janë kursime të vitit 2016 dhe si subjekti ashtu edhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar pakësim të gjendjeve *cash* në DPV-në e vitit 2016.

12.7. Në vlerësim të faktit se në këtë vit nga subjekti janë deklaruar, ndër të tjera, kursime *cash* në shumën 350.000 lekë, si dhe është deklaruar e paguar një pjesë e huas së marrë nga babai i bashkëshortit në shumën 200.000 lekë (pa datë të saktë të deklaruar), nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ dhe deklarimet e subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortit), u vlerësua dhe u krye një analizë paraprake financiare për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur për blerje/krijim të pasurive (përfshirë edhe likuiditete të deklaruar në *cash* në shumën 350.000 lekë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara dhe deklaruar për këtë periudhë, nga e cila duket se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë mundur të dokumentojnë burimet financiare të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive (blerje autoveture dhe krijim të gjendjeve *cash* në banesë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruar dhe evidentuara për vitin 2016.

12.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.9. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Në lidhje me draft analizën e kryer nga Komisioni, më rezultoi e nevojshme që të sqaroj disa momente faktike, të cilat sqarojnë edhe këtë pamundësi paraprake, duke dëshmuar në përfundim se me të*

ardhurat në familje e kemi pasur të mundshme për të blerë automjetin në shumën 300.000 lekë dhe siguruar kursime në masën 350.000 lekë.

Sikurse jam përpjekur të sqaroj më sipër në rubrikën 'kurimet cash', për gjithë periudhën e të qenit subjekt deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003, në fund të çdo viti (31/12), si gjendje cash gjithmonë kam deklaruar vlerën që ka rezultuar në këtë datë dhe asnjëherë shtim apo zvogëlim të likuiditeteve. Kjo mënyrë deklarimi ka qenë e shprehur edhe në faktin se në deklaratën Vetting e vetmja gjendje cash ekzistuese dhe e deklaruar ka qenë, pikërisht, shuma 350.000 lekë, e cila njëkohësisht përfaqëson kursimin e vetëm nga gjithë ecuria, ndër vite, derisa u plotësuar dhe dorëzuara deklaratat Vetting.

*Një argument tjetër, i cili dëshmon këtë konsiderim dhe mënyrë të plotësuarit të referimit vetëm të shumës gjendje në fund të çdo viti, i përket edhe situatës se, nëse këto shuma do të ishin shtesa, nuk do të ishte nevojshme qoftë marrja e huas në vitin 2013 nga babai i bashkëshortit, ashtu edhe likuidimi më i hershëm i kësteve të huas së marrë në vitin 2009, apo edhe i kredisë së të njëjtit vit. Por kursim real dhe të deklaruar kanë qenë vetëm gjendjet cash të deklaruara çdo fundvit. Për këtë arsye, në draft analizën financiare, përlllogaritja e gjendjes së kursimit në shumën 350.000 lekë vetëm për vitin 2016, nuk pasqyron gjendjen reale të faktit, pasi deklarimi i kësaj shume, përfshin edhe ecurinë e vitit më të hershëm i çelur në masën 300.000 lekë. Për këtë arsye, gjendja reale e rritjes së likuiditeteve në fund të vitit 2016 ka qenë vetëm shuma prej 50.000 lekësh dhe jo 350.000, sikurse rezulton në tabelë. Reflektimi i ndryshimit të mësipërm, duke u ndryshuar gjendja e likuiditetit nga 300.000 lekë si çelje e vitit 2016, kundrejt një shtese prej 50.000 lekësh në fund të këtij viti, përmbys analizën financiare, nga një pamundësi në shumën 622.181 lekë, në një gjendje pozitive prej 86.411 lekësh. I kërkoj Komisionit që të konsiderojë kërkimet e mësipërme, duke arritur në konkluzionin se unë dhe familja, nga të ardhurat e siguruara nga pagat, kemi pasur mundësi për të blerë automjetin me targa ***, në shumën prej 300.000 lekë”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

12.10. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimet, si dhe mundësitë financiare për blerjen e automjetit në datën 15.11.2016, vlerësoi se ato nuk janë bindëse.

12.11. Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën Vetting dhe atyre periodike, si dhe deklaratimet e subjektit, mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

12.12. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarimeve të kursimeve është i pambështetur në prova dhe në ligj.

12.13. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë

të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet cash, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

12.14. Në përfundim, trupi gjykues çmon se deklarimet nga subjekti, nuk kanë vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklarimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit prej tyre të këtyre kursimeve.

12.15. Për rrjedhojë, nga trupi gjykues kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet, u llogaritën sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat periodike/vjetore. Marrja në konsideratë e likuiditetit të pretenduar nga subjekti, është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

12.16. Nga sa më sipër arsyetuar analiza financiare përfundimtare e kryer, për subjektin e rivlerësimit rezultoi në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2016 në shumën 622.181 lekë.

12.17. Trupi gjykues, vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2016, në shumën prej 622.181 lekësh, nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare, është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar e duke çmuar se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

13. Përdorimi i automjetit tip “*”, me targa *****

13.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar se me aktpërdorimin nr. ***, datë 29.10.2016, kanë përdorur mjetin e tipit “***”, me targa ***, ngjyrë gri, në pronësi të shtetasit R.D (vëllai i subjektit). Si dokumentacion bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozitua aktpërdorim mjeti nr. ***, datë 29.10.2016, ku shtetasi R. A.D, pronari i mjetit “***”, me targa ***, deklaron se ia lë këtë mjet në huapërdorje shtetasve E. dhe Enerjeta Shehaj, për një afat 5-vjeçar.

13.2. Me kontratën për shitblerje automjeti nr. ***, datë 15.3.2015, shtetasi G.V.Z. (nipi i subjektit), në cilësinë e blerësit ka blerë nga shtetasi R. D automjetin tip “***”, viti i prodhimit 2006, kundrejt çmimi prej 8.000 euro.

13.3. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë dalë me automjetin me targë *** në datën 28.11.2015, në pikën kufitare të *** dhe kanë hyrë po nga kjo pikë kufitare më 30.11.2015. Në këtë periudhë, kur është përdorur ky automjet nga subjekti dhe personi i lidhur, nuk ishte blerë nga vëllai i subjektit (person tjetër i lidhur), por ka qenë në pronësi të shtetasit G.Z (nipi i subjektit).

13.4. Referuar informacionit nga DPSHTRR-ja, me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, rezulton se automjeti me targa ***, është blerë me kontratën e shitblerjes, datë 15.3.2015, nga blerësi G.Z kundrejt çmimit 8,000 euro dhe me kontratën e shitblerjes, datë

29.10.2016, automjeti i tipit “****”, me targa ***, i është shitur shtetasit R.D kundrejt shumës 400.000 lekë.

13.5. Nisur nga faktet që: (i) automjeti është përdorur nga subjekti dhe bashkëshorti i saj para se të blihej nga personi tjetër i lidhur; (ii) subjekti ka përfituar aktin e përdorimit në datën 29.10.2016, kohë kur ky automjet i është shitur vëllait të subjektit, i kaloi barrën e provës subjektit që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të blerësit të automjetit, me targa ***, z. G.Z për të shmangur, tej çdo dyshim të arsyeshëm, që nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016..

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

13.6. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: “Në datën 15.11.2016 kemi përdorur familjarisht automjetin me targa ***, vetëm njëherë dhe, konkretisht, në udhëtimin 2-ditor drejt ***.

Kemi konstatuar se automjeti nuk kishte të lidhur kontratën për sigurimin e detyrueshëm TPL, i cili përbën një dokument të domosdoshëm për të qarkulluar brenda vendit, e sigurisht që as siguracionin Karton Jeshil, të nevojshëm për të udhëtuar jashtë Shqipërisë. Në kontratat e sigurimit, bashkëshorti rezulton në tagrin e përdoruesit, sikurse ka qenë edhe qëllimi i përdorimit të saj, ndërkohë që në lidhje me afatin e lëshimit të tyre, këto kontrata, janë lidhur me afatet më të shkurtra² të mundshme”.

13.7. Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit/blerjes së automjetit nga nipi G.Z në mars të vitit 2015, subjekti ka depozituar dokumentacionin në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen në shumën 8.000 euro, lidhur me të ardhurat e nipit dhe motrës së saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

13.8. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimet, si dhe mundësitë financiare për blerjen e automjetit në përdorim, ka arritur në konkluzionin se G. Z, nipi i subjektit, në cilësinë e blerësit dhe nëna e tij, njëkohësisht dhe motra e subjektit kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në datën 15.3.2015.

13.9. Referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit, provuar gjatë hetimit në Komision, subjekti kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit përcaktohej se: “Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”.

²Për siguracionin e detyrueshëm TPL, për qarkullimin brenda Shqipërisë, nuk ka një policë sigurimi më të shkurtër sesa 1 vit. Ndërsa për sigurimin Karton Jeshil, të detyrueshëm për të udhëtuar jashtë Shqipërisë, nuk ka një siguracion më të shkurtër sesa 15-ditor.

13.10. Për sa më sipër, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, duke mos e deklaruar përdorimin e këtij mjete prej nipit të saj, por duke deklaruar përdorimin vetëm nga vëllai i saj, i cili ishte blerësi i mëvonshëm i kësaj pasurie të luajtshme.

13.11. Përtej këtij konkluzioni, për sa u provua mundësia financiare për pronarin e parë të automjetit, nipi i subjektit, lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky automjet është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj.

Trupi gjykues vlerëson se diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 2016 nuk janë në masën që cenojnë besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë mase nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ajo nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Enerjeta Shehaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

14. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39 pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin e deklasifikuar plotesisht ku informon sa vijon:

14.1. Referuar deklaratës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, grupi i punës konstatoi se: formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

14.2. Për subjektin e rivlerësimit Enerjeta A. Shehaj nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

14.3. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.*

Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk konstatoi *indicie*, informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

15. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor nga ku rezultoi si vijon.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti ka aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti kualifikon drejt marrëdhënien juridike, njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit. Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ, referon në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti ka manifestuar aftësitë e duhura në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të arsyetuara, janë të qarta, të kuptueshme. Qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga të dhënat statistikore konstatohet lehtësisht se subjekti ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë që përbën trefishin e standardit minimal. Në të pesë dosjet e vëzhguara është shkelur afati standard i gjykimit nga subjekti, megjithatë, në përmbajtje të këtij raporti është theksuar se ligji specifik nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative”, i miratuar më vonë se vendimi nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, nuk parashikon afat për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallën e parë të gjykimit administrativ, përveç afateve specifike të parashikuara në nenet 25, 26 e 27 të tij, afate që rezulton të jenë respektuar nga subjekti në katër dosjet e vëzhguara.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore. Duke i kushtuar rëndësi veprimeve përgatitore, subjekti përfundon gjykimin me 1-3 seanca gjyqësore. I kushton rëndësi edhe dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve. Ndjek radhën e veprimeve procedurale, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar të cilat janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit, për periudhën objekt vlerësimi profesional.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti por edhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presionit të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Ka aftësi komunikuese me palët gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

b) Aftësia për të bashkëpunuar.

Janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar.

Subjekti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 16 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe ka marrë pjesë në 26 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve ka një lidhje me detyrën e gjyqtarit administrativ.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale

Trupi gjykues, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIMET

16. Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimet si vijon:

16.1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit³, me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2021, bazuar në nenin B, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pika 11 e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, ka depozituar në Komision opinionin për subjektin, duke kërkuar që të verifikojë dhe kontrollojë dosjet e vendimmarrjeve të subjektit që ju takojnë denoncuesve: SH.Ç, shkurt 2019; N.M, qershor 2019; N.Sh, nëntor 2019; V.A, shtator 2020. Analiza e këtyre dosjeve, shprehet opinioni, është i rëndësishme për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

16.2. Komisioni⁴ i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me çështjet gjyqësore me palë ankuesit si me sipër. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁵ ka depozituar në Komision fotokopje të dosjes gjyqësore me nr. *** vendimi, datë 23.7.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë paditëse Sh.Ç dhe palë të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave. Dosjet e tjera janë sjellë në Komision nga Gjykata Administrative e Apelit.

³1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Europian.

3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: (a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik; (b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit; (c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit; (ç) kanë të drejtën të marrin të gjitha informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat.

⁴Shkresë nr. *** prot., datë 27.9.2021.

⁵Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2021.

Denoncim i shtetases N.SH

16.3. Denoncuesja denoncon subjektin për: zvarritje të procesit; shkelje të procedurës; keqinterpretim të ligjit material dhe procedural; arsyetimin e vendimit tej afatit ligjor. Denoncuesja është palë paditëse në çështjen administrative me palë të paditur ZVRPP-ja Tiranë dhe ZQRPP-ja, me objekt padie “detyrimi i palës së paditur të pajisë paditësen me certifikatë pronësie kopje fragmenti hartë treguese dhe kopje karteles pasurie për pasurinë apartament banimi në rrugën “****”, pa. 2, shk. 2, ap. 16, *** z. k. ***, vol., f. 147”. Denoncuesja pretendon pronësinë mbi një apartament banimi në ***, i cili është i regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të personave të tretë.

Bazuar në dokumentacionin e dosjes rezulton se paditësja nuk e ka zgjidhur në themel mosmarrëveshjen në lidhje me pronësinë e apartamentit në gjykimin e përgjithshëm (civil). Paditësja ka kërkuar regjistrim dhe lëshim certifikatë pronësie nga ZVRPP-ja Tiranë, e cila nuk e ka pajisur me dokumentin e kërkuar. Refuzimi nga ZVRPP-ja e ka detyruar t’i drejtohet gjykatës më kërkesëpadi me objekt detyrimin e ZVRPP-së të bëjë regjistrimin e pronës në emrin e saj dhe të fshijë nga regjistrat e pasurisë së paluajtshme emrat e personave të tretë. Në përfundim të gjyqimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur: Rrëzimin e padisë duke arsyetuar se nuk mund të preken regjistrat nga pala e paditur, e cila është administrator i tyre pa qenë prezent një mënyrë ligjore e njohur dhe e normuar nga Kodi Civil për të mundësuar kalimin e pronësisë apo ndryshimin e saj.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova lidhur me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.4. Subjekti, në përgjigje të barrës në lidhje me këtë denoncim, ndër të tjera, deklaroi se: *“Në bazë të nenit 7, pika ‘b’ e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative ...”, Gjykata Administrative ka në kompetencën e saj të shqyrtojë mosmarrëveshjet ‘që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme apo të mosveprimit të organit publik ...’; për të verifikuar ligjshmërinë e veprimit/mosveprimit kam hetuar në drejtim të shkaqeve mbi të cilat i padituri nuk pranon të regjistrojë në emër të paditëses N.SH pasurinë e paluajtshme të pretenduar në pronësi të saj”.*

Në bazë të neneve 24, 25, 32, 44 dhe 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe neneve 18, 30, 42 dhe 47 të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, përcaktohen qartë të drejtat dhe përgjegjësitë që ka zyra e regjistrimit në raport me titujt dhe të drejtat që janë të detyrueshme për regjistrim. Në konceptimin e krijimit të vetë zyrës së regjistrimit sipas ligjit ajo është krijuar dhe funksionon si një institucion që administron regjistrin e pasurive të paluajtshme, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme. Në këtë kuptim, ai është një institucion që administron dhe regjistron në bazë të kriterëve ligjore titujt dhe të drejtat e tjera që lidhen me pasuritë e paluajtshme. Zyra e regjistrimit, në asnjë rast nuk ka tagër dhe as kompetencë të krijojë, ndryshojë apo shuajë tituj të caktuar.

Në bazë të nenit 192 të Kodit Civil: “Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji”. Ndërsa neni 193 i Kodit Civil përcakton në mënyrë të shprehur aktet juridike/ligjore që duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme⁶. Në bazë të hetimit gjyqësor të zhvilluar ka rezultuar se pasuria objekt shqyrtimi gjyqësor rezultonte e regjistruar në zyrën e regjistrimit në emër të personave të tretë, të cilët e kishin regjistruar në bazë të një titulli. Në këto kushte, në mungesë të një vendimi gjyqësor apo të një akti tjetër që e konsideronte të paligjshëm apo që e shfuqizonte këtë regjistrim/titull e bënte të pamundur veprimin e zyrës së regjistrimit sipas kërimit të paditëses për të fshirë regjistrimin ekzistues. Në përfundim, në lidhje me këtë është paraqitur ankim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për ekzistencën e shkeljeve të mundshme për të iniciuar një procesim disiplinor.

Me vendimin nr. *** prot., datë 28.10.2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konstatuar se nuk evidentohen të dhëna që tregojnë se sjellja dhe veprimet e magjistrates Enerjeta Shehaj nuk përbëjnë shkelje disiplinore. Mbi bazën e ankimit ndaj vendimit të ILD-së, me vendimin nr. ***, datë 9.3.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur refuzimin si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesja N.SH kundër vendimit nr. *** prot., datë 28.10.2021, të ILD-së. Mbi ankimin e palëve, çështja ndodhet në pritje të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, duke mos pasur një vendim përfundimtar të formës së prerë. Gjendja aktuale e procedurës e klasifikon këtë çështje në rezervën e parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për mospërfshirje në vlerësimin e aftësive profesionale.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

16.5. Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi dosjen e çështjes dhe dëgjoi subjektin e rivlerësimit në shpjegimet e saj, vëren se çështja objekt denoncimi ndodhet në pritje të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit. Në lidhje me procedurën e zhvilluar nga subjekti gjatë gjykimit në shkallë të parë, trupi gjykues nuk ka konstatuar ndonjë shkelje të kryer nga subjekti, marrë në konsiderate nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, kjo çështje nuk përfshihet në vlerësimin e aftësive profesionale dhe, megjithatë, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se bazuar në praktikën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë⁷, vendimmarrja e subjekti të

⁶Neni 193 i kodit Civil: Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: (a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre; (b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme; (c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme; (d) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit; (e) aktet me të cilat krijohet një shoqëri që ka në pronësi pasuri të paluajtshme; (ë) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme.

⁷Vendim nr. ***, datë 13.2.2018; organet publike në fushën e veprimtarisë së tyre kanë detyrimin e garantimit të të drejtave, si dhe moscenimin e tyre nga subjekte të tjera duke refuzuar kryerjen e veprimeve të paligjshme, që passjellin në forma të ndryshme tjetërsimin e këtyre të drejtave. Në këtë kuptim, ZVRPP-ja si organ publik ka detyrimin që të garantojë subjektet se veprimet në regjistrin e pasurive kryhen mbi bazën e një akti të rregullt noterial, një akti administrativ të nxjerrë sipas ligjit ose një veprimi gjyqësor të formës së prerë, duke siguruar moscenimin e titujve në regjistra nga subjektet e tjera dhe refuzuar kryerjen e veprimeve të caktuara si për shembull tjetërsimin e pronës se paluajtshme.

rivlerësimit është në përputhje me ligjin dhe nuk përmban indikatorë që çenojnë kriteret e përcaktuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Denoncimi i denoncuesit N.M

16.6. Çështja administrative me palë: paditës – N.M, i paditur: Bashkia Tiranë; K.F; shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.; si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, person i tretë: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1, me objekt “pavlefshmëri e titullit të pronësisë për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, sip. 1650 m², në emër të të paditurit K. F”.

Pavlefshmëri e pjeshme e lejes së ndërtimit nr. ***, datë 10.10.2014, e Bashkisë Tiranë në favor të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. Detyrimin e palëve të paditura ta njohin pronar për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, me sip. 300,2 m², sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 9.12.2016, të lëshuar nga ALUIZNI. Detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të bëjë regjistrimin në regjistrat e pasurive të sipërfaqes 300,2 m² në emër të z. N.M. Detyrimin e ZVRPP-së Tiranë që të fshijë nga regjistrat e saj regjistrimin si pronar për të paditurin K.F për pasurinë nr. ***, z. k. *** për sip. 300,2 m² dhe fshirjen e regjistrimit të çdo kontrate sipërmarrjeje mbi këtë pronë. Paditësi ka ndërtuar një shtëpi njëkatëshe në parcelën ndërtimore me sip. 300,2 m², në vitin 1992 dhe e ka gëzuar nga viti 1992. Bazuar në ligjin për legalizimet paditësi ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit të tij dhe ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit nr. ***, datë 17.7.2006, pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Tirana 1.

Në vazhdim të procedurave të legalizimit është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 9.2.2016, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1. Pas marrjes së lejes së legalizimit paditësi i është drejtuar ZVRPP-së Tiranë për të regjistruar pronën. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.4.2016, ZVRPP-ja Tiranë i kthen përgjigje paditësit se parcela ndërtimore objekt regjistrimi mbivendoset pjesërisht me pasurinë nr. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “arë”, në pronësi të shtetasit K.F, në *** dhe po në këtë shkresë i kërkohet ALUIZNI-t Tirana 1 që të konfirmojë VKM-në e shpronësimit në lidhje me pasurinë nr. *** në pronësi të shtetasit K.F. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se gjatë gjykimit paditësi ka disponuar të drejtën e padisë⁸, duke kërkuar pakësimin e objektit të saj, duke hequr dorë nga gjykimi i kërkimeve 1, 3, 4 dhe 5 të kërkesëpadisë.

Krahas ankimeve administrative, i biri i paditësit shtetasi M.M ka bërë një kallëzim penal, ku ka kërkuar ndjekje penale për personat përgjegjës për dhënien e lejes ndërtimore, pasi KRRT-ja e Bashkisë Tiranë ka dhënë leje ndërtimi në kundërshtim me ligjin sepse leja zhvillimore me nr. ***, datë 20.8.2014, e Bashkisë Tiranë, lëshuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. është në kundërshtim me VKM-në Nr. ***, datë 22.8.2014, e cila pezullon dhënien e çdo lejeje zhvillimore deri në konstituimin e organeve të reja të pushtetit lokal. Në datën 20.3.2017, Prokuroria pranë

⁸Neni 185 i Kodit të Procedurës Civile “Ndryshimi i shkakut ligjor dhe i objektit të padisë” parashikon: “Paditësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë. Kur ndryshimet e mësipërme bëhen në mungesën e të paditurit ose të personave të tretë të thirrur në gjykim, duhet t’u komunikohen atyre me shkrim. Nuk quhet shtesë e objektit të padisë, kërkimi i kamatës ose i të ardhurave të tjera të objektit”.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, urdhëroi regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 20.3.2017, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”.

Në kuadër të hetimeve Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të kryejë ekspertimin grafik duke caktuar ekspert të fushës me detyrat përkatëse. Gjykata, për nevoja të hetimit gjyqësor, ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, bazuar në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale jep informacionin si vijon: (i) ky procedim penal është duke u hetuar; (ii) është sekuestruar praktika e dhënies së lejes së ndërtimit me nr. ***, datë 10.10.2014; është caktuar ekspert; (iii) aktekspertimi nuk është administruar ende.

Në seancën e datës 11.12.2017 gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të paditësit me arsyetimin se për nxjerrjen e këtij akti administrativ pala e paditur nuk ka shkelur në mënyrë flagrante ligjin dhe, për rrjedhojë, akti administrativ nuk është absolutisht i pavlefshëm. Me shkresën nr. *** prot., datë 15.4.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informon Komisionin se procedimi penal nr. *** për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 është dërguar për gjykim me datë 19.4.2019.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.7. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës ndër të tjera, shpjegon se: *“Çështja objekt ankese rezulton të jetë ankimuar dhe dosja ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këtë situatë fakti dhe në përputhje me nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sa kohë që çështja ndodhet në gjykim, tej shkaqeve që mund të lidhen me shkelje procedurale të evidentuara eventualisht në shkallën e parë, do të ishte i nxituar dhe paragjykes për një proces të rregullt ligjor. Në bazë të parimit të ‘zbatimit të ligjit në kohë’, si dhe të përcaktimit të nenit 37, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 të titulluar ‘kufijtë e shqyrtimit të çështjes’, në të cilin përcaktohet se ‘Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ’, për shqyrtimin e pretendimit të paditësit ka qenë i aplikueshëm legjislacioni në fuqi në kohën e lëshimit të aktit administrativ objekt ankimi gjyqësor për këtë arsye, konflikti do të shqyrtohej sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në atë periudhë, mbi bazën e të cilave është bazuar edhe nxjerrja e akteve administrative. Çështja objekt gjykimi lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin ligjor të kushteve dhe kriterëve të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Sipas praktikës tashmë të konsoliduar të Gjykatës së Lartë, në rastet kur kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ, gjykata e shkallës së parë nuk shqyrton thelbin e tij, por mjaftohet vetëm me verifikimin e kushteve të kërkuara nga neni 116, i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative. Referuar vendimit nr. 2/2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë gjykata që shqyrton çështjen është e detyruar të zbatojë me rigorozitet kërkesat e nenit 116 të Kodit të Procedurës Administrative, duke u mjaftuar vetëm me verifikimin e tre rasteve që parashikohen në të. Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptim të këtij*

Kodi në rastet e mëposhtme: (i) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; (ii) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; (iii) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji; në rastin konkret akti administrativ rezultonte i lëshuar nga një institucion i identifikuar, që ishte Bashkia e Tiranës, organ i identifikuar. Së dyti, institucioni lëshues i aktit administrativ rezulton të ketë emetuar një vendim, i cili njihet nga legjislacioni i posaçëm si një e drejtë ekskluzive e Bashkisë. Në lidhje me pikën e tretë të nenit 116 të Kodit të Procedurës Administrative, në kuadër të rasteve të pavlefshmërisë absolute të akteve, ajo i referohet situatës kur akti i lëshuar të jetë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji. Në rastin konkret, natyra e pretendimeve të palës paditëse shtrihej në gjerësinë e shkaqeve që nuk përbënin shkelje flagrante të ligjit në kuptimin e pavlefshmërisë absolute të tyre. Sikurse rezultoi, leja e ndërtimit ishte nxjerrë në administrim të të gjitha akteve që ligji i parashikonte të detyrueshme për të bërë të mundur lëshimin e lejes.

Nga aktet në dosje nuk rezulton që paditësi të ketë kërkuar pezullimin e gjykimit në asnjë rast. Nëse një kërkesë e tillë do të paraqitej nga të gjitha palët, gjykata do të ndodhej në kushtet e nenit 297, germa 'b' e Kodit të Procedurës Civile sipas të cilit gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur '(a) ... (b) kërkohet nga të dyja palët', pra një kërkim nga të dyja palët për pezullimin e gjykimit, nuk e linte më në diskrecion/vlerësim të gjykatës pezullimin e gjykimit, por do përbënte një fakt që do ta detyronte këtë të fundit të dispononte me pezullimin e gjykimit të çështjes'.

Në përfundim i kërkoj Komisionit që të pranohen dhe vlerësohen shpjegimet e mia dhe çdo pretendim i lidhur me interpretimin e zbatimin e ligjit procedural e material mbi themelin e çështjes mbetet një atribut vlerësimi i një gjykate më të lartë, e cila ende nuk është shprehur mbi çështjen, duke e përjashtuar kështu mundësinë e verifikimit të saj, në bazë të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

16.8. Në lidhje me këtë çështje, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti kishte kërkuar informacion nga organi i prokurorisë për procesin penal që po zhvillohej lidhur me falsifikimin e dokumenteve, në bazë të të cilit kishte dalë leja e ndërtimit dhe nuk arriti të shpjegojë bindshëm se përse edhe pasi mori njoftim nga ky organ se ishte duke u kryer hetim nuk mori masën e pezullimit të gjykimit deri sa të dilnin rezultatet e ekspertimit grafik të dokumentacionit të sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit, por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”, vlerëson se ky denoncim i vetëm mund të shërbejë si provë për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

Denoncimi i shoqërisë “V.A”

16.9. Denoncuesi ngre pretendime për moszbatim të ligjit dhe mosthirrjen në gjykim si palë e tretë në lidhje me çështjen me paditës ***, i paditur Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me objekt “Ndryshimi i vendimit nr. *** i AKEP-it “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësit *** me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm *** sh. a. dhe ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. *** “Për miratimin e dokumentit: rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në rrjetet celulare – dokumenti përfundimtar”, duke përcaktuar nivelin maksimal të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të *** (lekë/min data 1.12.2018 deri në një vendim tjetër të AKEP-it, ose alternativisht. Detyrimin e AKEP-it për të ndryshuar vendimin nr. *** “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësit *** sh. a. me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm *** sh.a. dhe pjesërisht vendimin nr. ***, datë 1.10.2018, të AKEP-it.

Pala e paditur – AKEP në këtë çështje argumenton para gjykatës se AKEP-i është një organ rregullator, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji nr. 9918, si dhe nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Sipas përcaktimeve të nenit 32 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, AKEP-i përcakton tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 4.2.2019, ka vendosur: Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së palës paditëse *** sh. a. shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 1.10.2018, “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësit *** sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm *** sh. a., rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Komisioni, në analizë të sa më sipër, vlerëson se subjekti, në zgjidhjen e drejtë të kësaj çështjeje nuk ka kërkuar mendimin e ekspertëve të fushës – nuk ka hetuar dhe marrë në konsideratë impaktin që sjell shfuqizimi i aktit administrativ për operatorët e tjerë në treg dhe nga kjo vendimmarrje mund të pësojnë dëme financiare. Rezulton se kjo çështje është ankimuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Gjykatën e Apelit dhe akoma nuk ka një vendimmarrje të formës së prerë në lidhje me këtë çështje administrative.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.10. Subjekti, në lidhje me këtë denoncim ndër të tjera, shpjegon se: *“V. ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Me vendimin nr. ***, të ILD-së është vendosur: ‘Arkivimi pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga subjekti *** sh. a.’ Çështja mbi themelin e saj është në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, duke e konsideruar në kuptimin kushtetues si çështje ende në gjykim dhe, si të tillë, të përjashtuar nga vlerësimi. Në lidhje me thirrjen e ekspertit në këtë çështje objekt i gjykimit, paditësi ka pasur kërkimin e tij mbi faktin nëse ishte respektuar diskrecioni nga organi publik i*

paditur, në kuadër të cenimit të parimeve të proporcionalitetit dhe sigurisë juridike. Pas këtij konstatimi, paditësi ka pretenduar që gjykata kryesisht apo përmes forcës së ligjit të detyronte të paditurin AKEP, që të përcaktonte një vlerë të caktuar mbi tarifën që do të mund të aplikonte paditësi A. . Në bazë të arsyetimit që kam bërë mbi këtë çështje, në raport me rregullimin ligjor dhe qëllimin mbi të cilin ishte krijuar dhe funksiononte AKEP, kam vlerësuar se objekti i gjykimit mund të ishte vetëm verifikimi nëse nga institucioni publik ishin respektuar parimet ligjore në raport me të qenit proporcional, koherent dhe i qëndrueshëm në vendimmarrje, në raport me pritshmëritë e ligjshme që krijohen ndaj tregut dhe indirekt edhe ndaj konsumatorëve. Ndërsa në lidhje me aplikimin e tarifave mbi të cilat do të aplikonte Paditësi, si një ndër operatorët celularë në vend, qartësisht në vlerësimin tim në këtë gjykim, kjo përbënte një kompetencë ekskluzive për të cilën vetëm AKEP, kishte potencialin ligjor dhe logjistik/teknik për të konkluduar me vendimmarrje mbi këto tarifa.

Në këtë kuptim, përcaktimi i tarifave në tregun e kompanive celulare, kërkon një vlerësim të gjerë të tregut, të pikënisur nga studime relativisht të shtrira në kohë, nga adaptime dhe analiza të tregjeve të Rajonit dhe Europës, të cilat kurrsesi nuk mund të përbëjnë kompetencë dhe as mund të konsiderohen nga kapaciteti i gjykatës”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

16.11. Trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi dosjen dhe çështjet dhe dëgjoji subjektin e rivlerësimit në shpjegimet në funksion të barrës së provës, verën se nga subjekti nuk ka shkelje të natyrës procedurale dhe duke mbajtur parasysh kërkesat e nenit E, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës analizon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e Komisionit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi vendimmarrjen e magjistratit, detyrë/kompetencë e organeve më të larta gjyqësore.

Në këtë drejtim, Komisioni bazohet në parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”. Analiza e provave dhe fakteve të çështjes është në kompetencë të Gjykatës Administrative të Apelit.

Denoncimi i denoncueses SH.Ç

16.12. Denoncuesja është paditëse në çështjen administrative me palë të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave. objekt: pavlefshmëri akti administrativ, gjobë, shfuqizim i aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr. *** prot., datë 15.3.2018 për gjobën prej 50.000 lekësh, nxjerrë nga DVT-ja Tiranë për moslëshim të kuponit tatimor. Shfuqizimin si të padrejtë të vendimit nr. *** prot., datë 8.5.2018, vendim i lënies në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimi nr. *** prot., datë 15.3.2018, për gjobën 50.000 lekë, nxjerrë nga DRT-ja Tiranë, për moslëshim të kuponit tatimor për të dytën herë për periudhën 2018/02 gjykata ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses SH.Ç”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses SH.Ç. Pretendimet e paditëses janë konstatuar nga gjykata si pretendime joligjore dhe të pabazuara në ligj dhe në prova. Vendimmarrja e subjektit është

përfundimtare, pasi vlera e gjobës ndaj paditëses është më e vogël se 20-fishi i pagës minimale, në shkallë vendi, bazuar në nenin 45, germa “a” e ligjit nr. 49/2012.

Subjektit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.13. Në lidhje me padinë objekt verifikimi nga Komisioni, nga ana e administratës tatimore është zhvilluar një kontroll fiskal për subjektin e znj. SH.Ç dhe sikurse rezultoi nga akt konstatimi dhe konfirmimi i vetë palës paditëse, subjekti ishte i pajisur rregullisht me kasën fiskale sipas detyrimit ligjor, por në momentin e kontrollit u konstatua se kundrejt një subjekti nuk ishte lëshuar kuponi tatimor që të përshkruante mallin e tregtuar dhe çmimin përkatës të tij. Në këto kushte, administrata tatimore ka gjobitur në shumën 50.000 lekë paditësen. Pas ezaurimit të ankimit administrativ, pala ka investuar gjykatën duke pretenduar se nga administrata tatimore janë shkelur dispozitat procedurale tatimore cenim të marrëdhënieve tatimpagues - shtet; fakti i pretenduar nga administrata tatimore nuk janë të vërteta etj., ndërkohë që i padituri DRT, kundërshton shkaqet e ngritura nga paditësi duke kërkuar që të disponohet me rrëzimin e tyre, pasi akti konsiderohet i ligjshëm dhe i lëshuar sipas procedurës tatimore. Si gjyqtare e çështjes, pasi ka verifikuar pretendimet e palëve ka konkluduar me rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar. Pasi është arsyetuar legjislacioni i aplikueshëm në rastin konkret, referuar nenit 122/1/b të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, mbi këtë bazë ligjore, vendimi i marrë nga i padituri DRT është vlerësuar i bazuar nga gjykata.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

16.14. Trupi gjykues i Komisionit, pasi kreu një vlerësim të rrethanave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatuar, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer një procedurë korrekte në shqyrtimin e çështjes, duke zbatuar dispozitat procedurale të parashikuara nga ligji i posaçëm nr. 49/2012, si dhe Kodi i Procedurës Administrative.

Sa i takon zgjidhjes së mosmarrëveshjes, trupi gjykues, bazuar në kërkesat e nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetues, neni 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, arrin në përfundimin se vlerësimi i aftësive profesionale nuk përfshin interpretimin e çështjes që bën magjistrati.

16.15. Denoncimi i shtetasit S.S, përcjellë nga “*”,**

Denoncuesi i ka bashkëlidhur formularit të denoncimit dosjen gjyqësore të vendimit nr. ***, datë 1.11.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi kërkon që ankimi i tij të merret si provë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

Denoncuesi dhe familjaret e tij janë përfitues të një toke bujqësore në ish-Komunën *** sipas ligjit nr. 7501/1991, me kryefamiljar z. R.S. Me AMTP-në nr. ***, datë 10.8.2000, ka rezultuar se Komisioni i Ndarjes së Tokës në *** i ka dhënë familjes së z. T.Xh sipërfaqen prej 4000 m². Ka rezultuar nga të dhënat e ZVRPP-së Tiranë se kjo pasuri është shitur te blerësi B.D, i cili më pas e ka shitur këtë pronë shoqërisë “***” sh.p.k. Komisioni i Verifikimit të vlefshmërisë ligjore të

krijimit të titujve të pronësisë me vendimin nr. ***, datë 26.11.2015, ka vendosur: “Shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. ***, datë 10.8.2000, për sipërfaqen 4000 m², në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga shtetasi T.A.Xh. Detyrimin e familjes bujqësore të paguajë vlerën prej 1.732.000 lekësh. Arsyet e këtij vendimi janë fakti që përfituesit e familjes së shtetasit T.Xh nuk kanë qenë asnjëherë banorë të fshatit *** dhe se përfitimi i tokës nga ana e tyre ishte realizuar në kundërshtim me ligjin. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 16.6.2016, ka pranuar padinë e paditësit, Prefekti i *** dhe ka shfuqizuar AMTP-në nr. ***, datë 10.8.2000, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit *** në emër të familjes së shtetasit T.Xh. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim dhe ky vendim ka marrë formë të prerë. Nga Bashkia Tiranë është lëshuar leja nr. *** prot., e miratuar me vendimin nr. ***, datë 2.5.2018, të kryetarit të Bashkisë, leje ndërtimi në favor të zhvilluesit, shoqërisë “****” sh.p.k. me objekt ndërtimin e një muri rrethues. Leja është lëshuar për një afat njëmuor. Denoncuesi ka paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Bashkinë Tiranë, IKMT-në pranë Bashkisë së Tiranës, shoqërinë “****” sh.p.k. me objekt shfuqizimin e lejes së ndërtimit dhe marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të aktit administrativ lejes së ndërtimit me nr. *** prot. dhe pezullimin e punimeve për objektin mur rrethues. Kjo çështje është gjykuar nga subjekti, e cila me vendimin nr. ***, datë 1.11.2018, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë-padisë së paditësit R.S”.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.16. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, në lidhje me këtë denoncim ndër të tjera, shpjegoi se: *“Pretendimet objekt të kësaj ankese nuk shtrihen mbi shkëlqje në lidhje me drejtimin e gjykimit, apo mohimit të të drejtave të palëve në proces, por me vlerësime të gjyqtarit që lidhen me çmuarjen e provave sipas bindjes së brendshme”.*

Për këtë arsye, në bazë të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 dhe nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, çështja objekt vlerësimi nuk mund të shtrihet në rrethin e atyre mbi të cilat mund të zhvillohet vlerësimi i aftësive profesionale, apo të dilet me gjetje apo konstatime konkrete mbi to në lidhje me arsyetimin dhe zbardhjen e vendimit sipas afateve ligjore.

E drejta e ankimit të palës në proces përfshihet në rrethin e të drejtave thelbësore të tij për të pasur një proces të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, për të ardhur në një përfundim për cenimin e figurës së gjyqtarit, në bazë edhe të ligjit nr. 96/2016, nuk mund të arrihet nga verifikimi në një çështje të posaçme gjyqësore dhe, për më tepër, duke u bazuar vetëm në pretendimet e njëjës palë. Cënimi i pozitës së gjyqtarit nuk mund të lidhet me një çështje dhe nuk mund të derivojë nga zgjatja e afatit të çështjes, pa hetuar apo verifikuar edhe arsyet eventuale të një vonese të mundshme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

16.17. Trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi dosjen dhe çështjet dëgjoi subjektin e rivlerësimit në shpjegimet në funksion të barrës së provës, vëren se është ushtuar ankim nga denoncuesi dhe

çështja është në pritje për t'u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Nga dokumentacioni i çështjes nuk u vërejtën problematika të natyrës procedurale nga subjekti.

Komisioni, lidhur me denoncimet e tjera paraqitur në Komision për subjektin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elementë për vijim të hetimeve lidhur me to.

Konkluzioni i Komisionit lidhur me denoncimet

Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elementë që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarës.

Komisioni vlerëson të theksojë se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk ka kompetencë të gjykojë mbi themelin e çështjes, tagra këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, mban qëndrimin se subjekti nuk arsyetoi bindshëm lidhur me gjetjet e Komisionit, lidhur me denoncimin e denoncuesit N.M, por duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese vlerëson se për sa ky ishte një rast i vetëm edhe i papërsëritur ai nuk shërben si provë për cënimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, rekomandimin e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, arrin në përfundimin se:

- a) subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enerjeta Shehaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 20.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ester Arapi